



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SPITALI RAJONAL DURRËS

NR. Prot _____

Data ____ . ____ .2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

- Objekt i procedurës kryesore: "Blerje te aparatures prove ushtrimore per kabinetin e Kardiologjise, per Spitalin Rajonal Durres",
- Fondi limit ne total: 1,896,666.70 (nje milion e teteqind e nentedhete e gjashte mije e gjashteqind e gjashtedhete e gjashte pike shtatedhete) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Spitali Rajonal Durres** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas **Shtojcës 1;**

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 29 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, ne te cilen eshte e parashikuar se: 1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH. 2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.

b. Lista e cmimeve te artikujve, sipas **Shtojces 2;**

Argumentimi: Kjo shtojce eshte pjese e setit te dokumenteve standarte te tenderit per proceduren e prokurimit te sipercituara.

c. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 3;**

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83/1 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Si dhe Nenit 83/2 ku përcaktohet se: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”

d. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore për 3 (tre) vitet e fundit (2020, 2021, 2022) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jete jo më e vogël se 40 % të fondit limit/vlerës së pritshme të kontratave, të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori ekonomik.

Argumentimi: Ky kriter, eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020,”Per Prokurimin Publik”, ne te cilin gjejme te percaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një **xhiro vjetore minimale** të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”*; si dhe ne piken 1 dhe piken 2/a te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: **Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) **40% te vleres se perlllogaritur te kontrates ose lotit ne procedurat e prokurimit nen kufirin e ulet monetar.****

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Legjislatori në nenin 55/4 të VKM 285/2021 i ndryshuar ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohe në Procedurën e Hapur të Thjeshtuar, e cila është 40 % e Fondit Limit të kontratës së shpallur.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenin 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave.

2.3 KAPACITETI TEKNIK:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **autorizimin** nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tregtim të pajisjeve mjekësore.

Argumentimi: Ky kriter vihet në përputhje me pikën 2 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar lidhur me kualifikimin profesional dhe aftësinë teknike: Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

2.3.2 Të vërtetojë që ka **të paktën 1 (një) Inxhinier** në stafin e vet të trajnuar për pajisjet mjekësore i cili do të kryej furnizim - vendosjen e pajisjes dhe aksesorët përkatës objekt prokurimi, të vërtetuar nëpërmjet **diplomës, çertifikatës/çertifikatave** së trajnimit sipas aparatures që furnizon, **CV-së, kontratës** individuale të punës. Inxhinjeri duhet të figurojë në **listpagesa** në 3 muajt e fundit para dates së hapjes së tenderit.

* Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës të DST. Shenim: Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla", si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin".

Argumentimi: Bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe pikave 4/b dhe 4/c të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohe që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqes **autorizim** nga prodhuesi / MAH / nëpërmjet te cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtoje pajisjet mjekesore objekt prokurimi. Autorizimi duhet te jete original i perkthyer ose kopje e perkthyer dhe noterizuar.

Argumentim: Ky kriter vihet në përputhje me piken 1 te nenit 77 (aftësia teknike) të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe me pikën 2 të nenit 41 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me qëllim zotërimin e reputacionit dhe besueshmërisë për zbatimin e kontratës si dhe rekomandimit të APP nr. 7998 datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”.

2.3.4 Ofertuesi duhet te paraqese per pajisjen mjekesore objekt prokurimi, **certifikaten CE** ose deklaraten e konformitetit (sipas kategorizimit perkates) per aprovim te standarteve, direktivave ne tregun European, origjinal i perkthyer ose kopje e perkthyer dhe noterizuar.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020 ”Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilen gjejme te percaktuar se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjën mbeshetje ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, te ndryshuar, ku percaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Gjithashtu ky kriter gjën mbeshetje ne rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve per kualifikim ne dokumentat e tenderit te procedurave te prokurimit publik“, rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr.145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise“.

2.3.5 Ofertuesi duhet te paraqese **autodeklarate** qe pajisja e shoqeruar me aksesoret perkates objekt prokurimi te jene te reja, te paperdorura dhe prodhim i viteve te fundit (2022-2023-2024).

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me nenin 4 pika 38, nenin 36 dhe 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne pikat 5, 6 dhe 8 te nenit 40 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, te ndryshuar, rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve per kualifikim ne dokumentat e tenderit te procedurave te prokurimit publik”, rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise“.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet te paraqese **deklaraten e garancise** per pajisjet, ne te cilen duhet te saktesoje se periudha e garancise te jete jo me pak se 2 (dy) vite , sipas afatit te percaktuar ne specifikimet teknike. Ne deklaraten për përmbushjen e afatit të garancisë (dy vite garanci përfshirë blerjen edhe zëvendësimin e pjesëve të difektuara me pjesë këmbimi të reja dhe origjinale ose edhe zëvendësimin e paisjes).

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me nenin 4 pika 38, nenin 36 dhe 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne pikat 5, 6 dhe 8 te nenit 40 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, te ndryshuar, rekomandimin e APP nr.

3341/1 prot, date 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentat e tenderit të procedurave të prokurimit publik”, rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësive”.

2.3.7 Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten **katalogje**, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofrohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 4 pika 38, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik i ndryshuar, si dhe me piken 6/b të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: [...] 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve e ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:[...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].

Paraqitja e katalogjeve për të gjithë artikujt që janë objekt prokurimi, është kërkuar me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së paisjeve mjekësore që operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike të përcaktuara në DST.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **ofertën teknike**, për pajisjen objekt prokurimi bashkë me aksesoret përkatës, në **formë tabelle**, ku të plotësohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Emertimi i katalogut të pajisjes / produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti ose Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit.

Argumentimi: Ky kriter është në përputhje me piken 1 të nenit 36 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohen.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor dhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

Gjithashtu ky kriter është në përputhje me piken 2 të nenit 40 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: 2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Në këtë kontekst është kërkuar dhe oferta teknike, me anë të së cilës do të behet e mundur verifikimi me i saktë i artikujve të ofertuar, specifikimeve të tyre, origjina, konformiteti etj me dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga ofertuesi.

2.3.9 Operatori do të paraqese **katalogun** e pajisjes ku të jënë shënuar (markuar) specifikimet teknike.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 4 pika 38, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik i ndryshuar, si dhe me pikën 6/b të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: [...] 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve e konomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:[...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].

2.3.10 Operatori do të kryejë furnizimin, instalimin dhe testimin e aparaturave me kostot e tij.

2.3.11 Operatori duhet të trajtojë stafin mjekësor pas instalimit të pajisjeve mjekësore në kabinetin përkatës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shtojca 5.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Paisja Proves Ushtrimore përbehet:

1. PC me programin (soft) e Proves Ushtrimore
2. Pista ecjes ose treadmill ergometer
3. Sistemi transmetimit të dhenave moduli EKG
4. Printer

Prova Ushtrimore do të jetë e paisur me program (soft) i cili do të komandojë dhe kontrollojë pistën e ecjes (treadmill ergometer) përmes protokolleve të përcaktuara me parë (standart) ose të krijuara nga përdoruesi (mjeku) .

Funksionet e sistemit:

- Mundësi futje/modifikime të informacioneve për pacientin
 - Ekzekutimin e një testi sforcimi duke programuar ergometrin (pistën e ecjes) sipas një protokollit të zgjedhur nga përdoruesi
 - Printimi i rezultateve në printer
 - Përmbledhja ose perseritja e ushtrimit
- Rezultatet e analizës
- Paraqitja e rrahjeve, Klasifikimi i rrahjeve, Klasifikimi i eventeve të aritmise, Pjerrësia dhe niveli ST, ST/RH

Specifikimet teknike të EKG:

12 derivacione (I, II, III, aVR-L-F, V1-6)
Kavo e pacientit me minimumi 10 fije të zëvendësueshme
CMRR nga 115dB -130dB
Konversioni A/D nga $\pm 300\text{mV}$ deri në $\pm 400\text{mV}$
Njohje të pacemaker -
Mbrojtje nga defibrilatori- standart
Transferim i të dhenave me Bluetooth/ WiFi/ usb
Sistemi punës Windows
Me njohje të pavarur të gjithë derivacioneve
Frekuenca kardiake 30-300 bpm
Filtrat –përkatës për marrjen e sinjalit

Karakteristikat kryesore:

Të shfaqen gjithmone gjatë proves të dhenat e pacientit (emer , mbiemer, moshe etj) HR, HRmax, HR target dhe % e HR target
Niveli ST, Presioni I gjakut, Mets, Treguesi ST/HR, gjendja e elektrodave.

Te kete faze para-ushtirimore
Te kete faze ushtirimore /rekuperimi me EKG ne kohe reale 3/6/12 6x2 kanale
Shirit eventi operator ose aritmi
Trend te rezultateve te analizes ST e azhornuar ne kohe reale
Trend: HR/METS, Treguesi ST, parametrat e pistes, Niveli ST, Pjerresia ST

Emri protokollit
Faza ku eshte protokolli
Parametrat e pistes (ergometrit)
Rregullimi i protokollit :Automatik ose manual, kontroll manual te ergometrit (pistes), Futja manuale ose automatike e NIPB, Alarm viziv dhe akustik.

Alarmet: Eventet ritmike, HR me e larte se targeti, Renie e HR me e larte se ajo e dhene nga operatori, BP sistolik ose diastolik me lart ose me poshte se kufiri i caktuar

Te dhenat minimale te PC (referuar AKSHI)

Sistemi operativ Min :Windows 10, 64 bit ose me shume
Procesori :7900 pike ose me shume
Ram: 8GB ose me shume
Hard disk: Min 500GB SSD
Ekрани min -21” LCD ose Led
Rezolucioni : min 1920x1080
Printeri lazer me leter A4
Ruajtja e te dhenave ne database lokale, kapaciteti 500-1000 ekzaminime

Pista e ecjes ose ergometri

I pershtatshem per t'u lidhur me PC, per proven Ushtrimore.
Me lartesi te ulet te ngjitjes, me rryp sigurie per pacientin, me krahe anesore , pa zhurme me funksionalitet te heshtur (silencioz)
Fuqia e motorrit:
Min: 1.8 KW- 2.8KW
Tensioni : 220V
Pesha e pacientit : 200 - 220 kg
Shpejtesia min: 0.5 km/h me gradim 0.1 km/h , shpejtesia max 24 km/h
Kontrolli lidhje kabell USB / Bluetuth/ WiFi me PC
Ngritja : variabel nga 0 -25% me rregullim 0.5 %
Me ndalim emergjence, me pulsant emergjence, me tapet kunder rreshqitjeve,

Certifikate Konformiteti 93/42/CE ose MDR .

Garancia 2 vjet.

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Argumentimi per specifikimet teknike jane vendosur ne baze **te materialit te pergatitjes se specifikimeve teknike dhe perlllogaritjes se fondit limit me nr. 473/3 prot., dt. 15.04.2024 te pergatitur nga grupi i punes i ngritur me urdherin e brendshem me nr. 473/2 prot., dt. 25.03.2024**, si dhe ne perputhje me nenin 4, pika 38 te Ligjin nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar nenin 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Argumentimi i fondit limit: Ne baze **te materialit te pergatitjes se specifikimeve teknike dhe perlllogaritjes se fondit limit me nr. 473/3 prot., dt. 15.04.2024 te pergatitur nga grupi i punes i ngritur me urdherin e brendshem me nr. 473/2 prot., dt. 25.03.2024**, argumentohet nga grupi i punes qe:

Per caktimin e fondit limit grupi i eshte referuar VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar Neni 76 “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit” *Pika 1. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon: germa b) studimi i tregut, bazuar ne mesataren e cmimeve te mara nga ky studim;*.

Nga sa me siper Grupi i eshte drejtuar me e-mail ne date 04.04.2024 kompanive qe ofrojne tregtim dhe sherbime mirembajtje per paisje mjekesore.

U paraqiten oferta me e-mail nga OE.

U ngarkua ne sistemin e prokurimit elektronik nga njesia e prokurimit: